

VENDIM
Nr.208, datë 21.4.2008

PËR PËRFUNDIMIN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE DHE PËRJASHTIMIN NGA SKEMA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË BANKËS ITALO-SHQIPTARE SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 11, pika 2 (f), nenit 23, pika 5, shkronja “b”, dhe pika 6, si dhe nenit 26, pika 1, të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, si dhe mbështetur në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.22, datë 12.3.2008 “Për revokimin e licencës së Bankës Italo-Shqiptare sh.a.”, vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.78, datë 12.12.2007 “Për miratimin e bashkimit me përthithje të Bankës Italo-Shqiptare sh.a. në Bankën Amerikane të Shqipërisë sh.a.”, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të ASD-së, Këshilli Drejtues i ASD-së

VENDOSI:

1. Të përfundojë sigurimin e depozitave në Bankën Italo-Shqiptare në datën efektive të përthithjes së Bankës Italo-Shqiptare sh.a. në Bankën Amerikane të Shqipërisë sh.a (1.1.2008), miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.78, datë 12.12.2007 “Për miratimin e bashkimit me përthithje të Bankës Italo-Shqiptare sh.a. në Bankën Amerikane të Shqipërisë sh.a.”.

2. Të përjashtojë Bankën Italo-Shqiptare sh.a. nga skema e sigurimit të depozitave për shkak të revokimit të licencës së saj, me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.22, datë 12.3.2008 “Për revokimin e licencës së Bankës Italo-Shqiptare sh.a.”.

3. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Depozitave (Sktori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave) të njoftojë me shkrim Bankën e Shqipërisë dhe Bankën Italo-Shqiptare për këtë vendim, si dhe të kërkojë nga Banka Italo-Shqiptare dorëzimin e certifikatës për sigurimin e depozitave.

4. Ngarkohet zyra juridike për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES
Dashamir Halilaj